



Bashkëpunimi tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës



Organizatat që zbatojnë projektin

- **Qendra Shqiptare për Konkureshmëri dhe Tregti Ndërkombëtare (ACIT)**

ACIT është një institut shqiptar i përqendruar në qeverisjen ekonomike, integrimin dhe rritjen e qëndrueshme. Qëllimi i aktivitetit të qendrës është përmirësimi i performancës së ekonomisë shqiptare dhe konkurrencës së saj, rritja e punësimit, gjithëpërfshirja dhe mirëqenia, si dhe promovimi i eksporteve dhe investimeve.

- **Instituti GAP**

GAP është një institut i formuar në tetor 2007 në Kosovë. GAP ka qenë direkt pjesëmarrës në dhjetëra grupe punuese qeveritare për hartim të politikave dhe hartimin e një numri të madh dokumenteve publike dhe ka publikuar me dhjetëra analiza dhe raporte.

- **Riinvest**

Riinvest është instituti më i vjetër në Kosovë nga 1995 që promovon zhvillimin modern ekonomik të bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Riinvest ka prodhuar analiza, publikime dhe raporte të ndryshme socio-ekonomike, ka organizuar aktivitete me vlerë të madhe ekonomike dhe biznesore për vendin, ka zhvilluar tregje, sektorë dhe ndërhyrje të tjera në vlerën zinxhirore.



Qëllimi i projektit

Informimi dhe vetëdijësimi i aktorëve politikë e institucionale dhe të sektorit privat lidhur me përfitimet e shfrytëzimit të potencialit ekonomik përmes rritjes së shkëmbimeve tregtare Shqipëri-Kosovë.



Objektivat e projektit

Hartimin e një analize të thelluar mbi pengesat dhe potencialet e integritit ekonomik midis dy vendeve;

Nxitjen e një debati gjithëpërfshirës të bazuar në fakte dhe analiza përtej retorikës politike;

Formulimin e rekomandimeve konkrete për autoritetet respektive mbi integrimin e mëtejshëm ekonomik dhe tregtar.

Metodologjia

- Rishikim i studimeve dhe raporteve ekzistuese;
- Monitorimi dhe analiza e zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe;
- Intervista me institucionet dhe përfaqësuesit e biznesit;
- Identifikimi dhe analiza e barrierave jo-tarifore;
- Analiza sasiore e të dhënave të tregtisë së jashtme;
- Vlerësimi i potencialeve të pashfrytëzuara;
- Hartimi dhe publikimi i dy drafteve të studimit;
- Formulimi i rekomandimeve të përbashkëta për autoritetet në formën e një 'joint policy memo'.



Rezultatet e pritshme

- Raport i detajuar mbi zbatimin e marrëveshjeve dhe pengesat ekzistuese për zbatimin e plotë;
- Përfshirja dhe strukturimi i gjithë problemeve konkrete të hasura nga përfaqësuesit e biznesit;
- Evidentimi i fushave dhe produkteve me potenciale të pashfrytëzuara;
- Formulimi i propozimeve për politikëbërësit, në formën e një roadmap me hapa konkrete;
- Promovimi dhe zhvillimi i një debati të hapur e gjithëpërfshirës për gjithë pikat e mësipërme.



Komunikimi i rezultateve

- Organizimi i dy tryezave për prezantimin dhe diskutimin e gjetjeve me bizneset, institucionet, ekspertët, akademikët, etj. Marrje e inputs për rekomandimet;
- Organizimi i një konference të përbashkët në Prishtinë për prezantimin e produkteve finale dhe fillimin e advokimit;
- Intervista dhe emisione në media mbi gjetjet dhe rekomandimet;
- Postime në rrjetet sociale me materiale infografike;
- Dërgimi i policy memo të përbashkët pranë institucioneve në të dy vendet;
- Prezantimi i rekomandimeve pranë komisioneve parlamentare të përkatëse.



FALEMNDERIT PËR VËMENDJE

